



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 457/2 Prot.

Shkodër, më 21.07 / 2025

VENDIM

Nr. 10, Datë 16.07.2025

“Mbi miratimin e transferimit kapital të objektit të investimit të përfunduar-Sistemim, Asfaltim rruga kryesore e varrezave në fshatin Kalldrun”- nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Malësi e Madhe ”

Këshilli I Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 16.07.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, “Mbi miratimin e transferimit kapital të objektit të investimit të përfunduar- Sistemim, Asfaltim rruga kryesore e varrezave në fshatin Kalldrun - nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Malësi e Madhe”, bazuar në neni 14, nenin 23, neni 77, 78, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Akt-Marrëveshjen me nr. 4168 Prot., datë 31.12.2021 të Bashkisë Malësi e Madhe dhe nr. 582 Prot., datë 30.12.2021 të Këshillit të Qarkut Shkodër, Për “ Bashkëpunim ndërvendor në fushën e infrastrukturës për kryerjen e investimit “Sistemim, Asfaltim rruga kryesore e varrezave në fshatin Kalldrun, Bashkia Malësi e Madhe “, VKQ Shkodër nr.17, datë 30.12.2021 ”Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 dhe PBA Përfundimtar 2022-2024” dhe shprehje ligjore nr.19/1, datë 11.01.2022, Çertifikates përfundimtare të marrjes në dorëzim të punimeve nr.197/1, datë 25.03.2025, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **17 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin kapital të objektit të përfunduar të investimit “Sistemim, Asfaltim rruga kryesore e varrezave në fshatin Kalldrun, Bashkia Malësi e Madhe”, nga Këshilli I Qarkut Shkodër, në Bashkinë Malësi e Madhe me vlerë investimi në shumën

4,792,080 lekë, shumë e cila do të kontabilizohet në librat kontabël të Bashkisë Malësi e Madhe.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Edmond NDOU

